EMRAT/ Tentuan të shisnin mina me telekomandë për llogari të një grupi kriminal, dy të arrestuar në Vlorë, policia jep detajet

08 Shkurt, 2023 15:46



Madhësia e tekstit:

Policia e Vlorës ka vënë në pranga dy të rinj nga Puka, Bledar Ukshini dhe Ardit Qamluku, të cilët tentuan që të shisnin disa mina me telekomandë për llogari të një grupi kriminal, në këmbim të 10 mijë eurove.

Ndërkohë janë sekuestruar 3 mina të montuara me lëndë të dyshuar eksplozive plastike C4, të lidhura me aparat celular, për t'u komanduar në distancë.

Njoftimi i policisë:

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve të Paligjshme në DVP Vlorë, në bashkëpunim me Forcën Operacionale të DVP Vlorë dhe Komisariatin e Policisë Himarë, si rezultat i një hetimi disajavor me metoda proaktive, nën drejtimin e Prokurorisë së Vlorës, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e prodhimit, shitjes dhe trafikimit të minave me telekomandë, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Knockout", në kuadër të të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

B. U., 31 vjeç dhe A. Q., 21 vjeç, të dy lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit".

Pas lokalizimit dhe prangosjes së këtyre shtetasve, në një lokal, në lagjen "28 Nëntori", shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit fizik ndaj tyre, i gjetën 3 mina me telekomandë, të montuara me lëndë të dyshuar eksplozive plastike C4, të lidhura me aparat celular, për t'u komanduar në distancë.

Nga veprimet hetimore dyshohet se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, do t'i shisin minat, për llogari të një grupi kriminal, kundrejt çmimit 10 000 euro.

Në bashkëpunim me Prokurorinë, po vijojnë hetimet për dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie kriminale dhe për vënien para përgjegjësisë ligjore të personave të tjerë të përfshirë.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: grupe kriminale | mina | Vlorë

TË NGJASHME

Gjendet një cantë e dyshimtë pranë një automjeti në Vlorë, reagon policia
07 Shkurt, 2023

Përfshihet nga flakët kodra e Kuzum Baba në Vlorë, dyshohet për zjarrvënje të qëllimshme
06 Shkurt, 2023

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Aksioni në Nikël/ Shkon në 21 numri i të arrestuarve, prangosët edhe një 51-vjeçar, detajet
09 Shkurt, 2023

Droga në thasët me pleh në Frakull, përfundon aktekspertimi, e gjithë sasia del kokainë
09 Shkurt, 2023

Provat e reja për "21 Janarin"/ SPAK shpall moskompetencën për kallëzimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe PS
09 Shkurt, 2023

Nga trafiku i qenieve njerëzore tek al i drogës, shkatërrohet rrjeti kriminal i lidhur me mafien shqiptare në Spanjë, 5 të arrestuar
09 Shkurt, 2023

Aksionet kundër trafikimit të lëndëve narkotike/ Tre të arrestuar në Francë, mes tyre një shqiptar, sekuestrohen 13 kg heroinë dhe 6 kg kokainë
09 Shkurt, 2023

EMRI/ Prostituonte vajza shqiptare dhe rumune, arrestohet në Rinas 38-vjeçari shqiptar që kërkohej nga Italia
09 Shkurt, 2023

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ "11 shkurti, dita që populli të thotë falëm e tij", Tedi Blushi: Ndryshimi i madh po afron!
09 Shkurt, 2023

Greqia dërgoi ekipe kërkimi dhe shpëtimi në Turqi, Mitsotakis premton mbështetje: Do të jemi në vijën e parë
09 Shkurt, 2023

"Gjinushi, një McGonigal i dytë në Akademinë e Shkencave"/ PD: Rama kërkon t'i japë një tjetër mandat në kundërshtim me Kushtetutën
09 Shkurt, 2023

"E ardhmja mbi gjithçka"/ Berisha publikon videon: Më 11 shkurt Shqipëria marshon drejt Tiranës!
09 Shkurt, 2023

FOTO/ Arabët "mësynë" në 'Old Trafford', 6 miliardë sterlina për "djajtë e kuq"
09 Shkurt, 2023

"A ka njeri këtu", momente zemërthyese nga kërkimet në Turqi, forca e shpëtimit dhe familjarët heshtin për të dëgjuar zëra nga rrënojat
09 Shkurt, 2023

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Rreth 30,000 njerëz janë evakuuar nga Kahramanmaras, provinca jugore turke pranë epiqendrës së tërmetit
09 Shkurt, 2023

Dick Marty, i kërcënuar me vdekje, "i rrëfen të gjitha" në një libër
09 Shkurt, 2023

Goditën me grushte mjeken, reagon QSUT: Dënojmë dhunën dhe kërkojmë mbështetje për punën tonë!
09 Shkurt, 2023

Veliaj inspekton punimet për shkollën "Xhezmi Delli": Tirana i respekton të gjithë, mos u merrni me ata që politikën e kanë 'sport'"
09 Shkurt, 2023

Debate në Kuvendin e Kosovës/ "Marrëveshje me vlera universale", Kurti pranoi planin franko-gjerman, Krasniqi e akuzon për mungesë transparence
09 Shkurt, 2023

"I papunë", Rey Manaj përfundon në treg, e duan në Serie A dhe La Liga
09 Shkurt, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.